



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 845/prot.

Ballsh, më 20.02.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 10, Datë 20.02.2025

“PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK
MALLAKASTËR PËR VITIN 2025”

-KËSHILLIT TË BASHKISË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe në bazë të Rregollores së Këshillit Bashkiak, pas shqyrtimit të raportit të paraqitur nga Sekretari i Këshillit Bashkiak për vitin 2025. Këshilli Bashkiak,

PROPOZON:

1. Miratimin e raportit të Këshillit Bashkiak për vitin 2025, i cili përmban analizën e veprimtarisë së institucionit për përmbushjen e detyrave të tij.
2. Ngarkohet Sekretari Këshillit Bashkiak për publikimin e tij në faqen zyrtare të Bashkisë..

SEKRETAR KËSHILLI

Zinaida Ahmetaj

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 845 Prot.

Ballsh, më, 20 / 02 / 2026

RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR PËR VITIN 2025

Për vitin 2025, Këshilli i Bashkisë Mallakastër, ka pasur një bashkëpunim të mirë dhe punë intensive në vendimmarrje, duke marr parasysh dhe kërkesat e paraqitura nga qytetarët për t'ju dhënë zë atyre, bazuar në ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe vendimin nr.12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër”.

Këshilli Bashkiak, si organ përfaqësues i qeverisë bashkiake, ka tre role kryesore:

1. Përfaqësues;
2. Vendimmarrës;
3. Mbikëqyrës.

Për secilin nga këto role të Këshillit Bashkiak po ju citojmë aktivitetet e kryera si më poshtë vijojnë:

1. Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2025:

Është synuar një komunikim dhe transparencë e vazhdueshme me komunitetin, duke publikuar në rretjet sociale Facebook, dhe në faqen web: <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sq/keshilli-bashkiak>, në kohën e duhur njoftimin për çdo mbledhje të këshillit bashkiak dhe duke vënë në dispozicion të gjitha projekt-vendimet e rendit të ditës në faqen web, aktivitetet e këshillit dhe dëgjuesat publike.

Konsultimet Publike – Viti 2025

Në zbatim të vendimit Nr. 56, datë 21.10.2024, mbi “Miratimin e planit të punës, planit të konsultimeve dhe planit të Bbuxhetit të Këshillit Bashkiak Mallakastër për vitin 2025” (dokumentacioni i plotë <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Vendimi-Nr.56-datë-21.10.2024.pdf>), si dhe bazuar në Rregulloren e Brendshme për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Mallakastër dhe Rregulloren e Konsultimit Publik (publikuar në [faqen](#)

zyrtare të Bashkisë Mallakastër), Këshilli Bashkiak Mallakastër ka organizuar dhe zhvilluar me sukses konsultimet publike për projekt-vendimet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Procesi i Konsultimeve Publike gjatë vitit 2025.

Në planin e konsultimeve publike janë parashikuar të organizohen konsultime publike për 5 tema;

- **Plani i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028**
- **Paketa Fiskale**
- **Buxheti i Bashkisë për vitin 2025**
- Ndryshim buxheti
- Planet e shqrbimeve

Buxheti i parashikuar për konsultimet publike ka qenë në vlerën 15.000 lekë, me zëra si letër, bojë për printim dhe mjete kancelarie në funksion të materialeve që do të konsultohen. Gjatë këtij viti, janë realizuar 7 konsultime publike për 5 projekt-aktsh kryesore:

- **Plani i Buxhetit Afatmesëm 2026-2028**
- **Paketa Fiskale**
- **Buxheti i Bashkisë për vitin 2026**
- **Plani i arsimit parauniversitar 2026-2028**
- **Plani Vendor për Emergjencat Civile**

Referuar planit, nuk janë realizuar dy konsultime të parashikuara, ndërkohë që janë realizuar dy konsultime publike (Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028 dhe Plani Vendor i Emergjencave Civile) që nuk kanë qenë të parashikuar në Planin e Konsultimeve publike. Për sa i përket konsultimit publik për iniciativa qytetare, nuk ka patur asnjë të tillë. Në këtë mënyrë Plani është realizuar 100%, dhe buxheti për konsultimet publike është shpenzuar 100%. Por Këshilli bashkiak nuk e ka realizuar fushatën informuese “Ditën e hapur”, e cila kishte të njëjtin buxhet të parashikuar prej 30000 lekësh..

Gjatë këtyre proceseve janë mbajtur **7 takime publike** me grupet e interesit. Për çdo projekt-vendim janë hartuar dhe publikuar:

- Projekt-vendimet e propozuara,
- Njoftimet për konsultim publik,
- Kalendarët e takimeve (në përputhje me modelin e miratuar në rregulloret e Këshillit Bashkiak),
- Materialet shoqëruese.

Të gjitha këto janë përgatitur dhe publikuar duke respektuar afatet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Pjesëmarrja dhe Dokumentimi i Takimeve Publike

Takimet publike janë mbajtur dhe janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale të Këshillit Bashkiak. Në këto takime kanë marrë pjesë:

- Përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë,
- Qytetarë dhe banorë nga njësitë administrative,
- Përfaqësues të grupeve të interesit.

Gjatë takimeve publike janë respektuar të gjitha procedurat përkatëse, duke përfshirë:

- Mbajtjen e procesverbaleve,
- Listat e prezencës,
- Dokumentimin me foto.

Të dhëna mbi pjesëmarrjen

Në konsultimin publik, në Njësitë Administrative Fratar, Kutë dhe Selitë, për Hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Plani Vendor për Emergjencat Civile , morën pjesë gjithsej **35 persona**, nga të cilët **17 gra**.

Në konsultimin publik, në qytetin e Ballshit dhe Njësitë e tjera Administrative, për Hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028, morën pjesë gjithsej **36 persona**, nga të cilët **10 gra**.

Në konsultimin publik, Njësitë Administrative Fratar, Kutë dhe Selitë, për Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028, morën pjesë gjithsej **21 persona**, nga të cilët **10 gra**

Në konsultimin publik, në qytetin e Ballshit dhe Njësitë e tjera Administrative, për Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028, morën pjesë gjithsej **24 persona**, nga të cilët **18 gra**

Në konsultimin publik, në Njësitë Administrative Fratar, Kutë dhe Selitë, për hartimin e: Paketa Fiskale 2026, Projekt Buxheti i vitit 2026, Projekt Buxheti Afatmesëm 2026-2028, morën pjesë gjithsej **26 persona**, nga të cilët **8 gra**.

Në konsultimin publik, në qytetin e Ballshit dhe Njësitë e tjera Administrative, për hartimin e: Paketa Fiskale 2026, Projekt Buxheti i vitit 2026, Projekt Buxheti Afatmesëm 2026-2028, morën pjesë gjithsej **51 persona**, nga të cilët **16 gra**.

Rezultatet dhe Vendimet Përfundimtare

Pas përfundimit të konsultimeve publike dhe zbatimit të procedurave ligjore, Këshilli Bashkiak miratoi projekt-vendimet përkatëse, të cilat më pas morën konfirmimin e ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit.

Për më shumë informacion, ju ftojmë të ndiqni publikimet në linket zyrtare të Bashkisë Mallakastër:

- https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Tabelat%20e%20PBA%202026-2028%20-%20Faza%201%20-%2020131%20-%20Bashkia%20Mallakast%C3%ABr%20-%202027_05_25.pdf
- <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Njoftim%20p%C3%ABr%20konsultim%20publik.pdf> dhe <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Projketvendim%20Nr.25%20Qershor%202025.pdf>

- <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Projketvendim%20Nr.24%20Qershor%202025.pdf> dhe
- <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/PAKETA%20FISKALE%20viti%20%202026.pdf> dhe
- <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Njoftim%20për%20konsultim%20publik%200.pdf>
- <https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sites/default/files/Projektvendim%20Nr.35%2C%20Datë%2010.09.2025%200.pdf> dhe
- <https://www.facebook.com/photo?fbid=1263087632520009&set=pcb.126308838585326>

7

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashksië.

Konkretisht janë depozituar ne total 23 kërkesa, asnjë ankesë, asnjë peticion, drejtuar Këshillit Bashkiak, dy prej të cilave kanë qënë kompetencë e këshillit, është bërë e mundur marrja e vendimeve. Kërkesat e tjera janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet është kthyer përgjigje brenda afateve dhe procedurave të caktuara.

Referuar Rregullores për strukturat komunitare, nga 42 fshatra të Bashkisë Mallakastër, tre janë pa kryetar; fshatrat Kash, Bejar dhe Rriban.

Aleancën e Grave Këshilltare ka nxitur një nisma me bazë gjinore për vitit 2025, e cila nuk u realizua:

- Kërkesë për parashikimin e instalimit të kamerave për ambjentet dhe sheshet publike dhe arsimore.

Ndërkohë Aleanca e Grave Këshilltare ka mbetur në të njëjtë nismë në 2026, e cila pritet të realizohet gjatë këtij viti, mqs në vitin 2025 nuk u realizua.

- Kërkesë për parashikimin e fondeve për instalimit e kamerave të sigurisë në ambjentet publike, arsimore dhe parkun e liqenit-Buxhein 2026.

2. Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer aktivitetet si më poshtë:

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në total 13 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 1 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë. Gjatë vitit 2025 është mbledhur Kryesia e Këshillit Bashkiak e cila ka vendosur mbi rendin e ditës në secilën mbledhje.

Komisionet e këshillit bashkiak janë mbledhur pesë herë; respektivisht:

- 28.01.2025: Komisioni Juridik, dy anëtarë nga pesë;
- 28.01.2025: Komisioni Ekonomisë, tre anëtarë nga pesë;
- 21.02.2025: Komisioni Juridik, një anëtarë nga pesë;
- 25.03.2025: Komisioni Juridik, dy anëtarë nga pesë;

- 25.04.2025: Komisioni Juridik, dy anëtarë nga pesë;
- 26.05.2025: Komisioni Juridik, një anëtarë nga pesë;
- 25.07.2025: Komisioni Juridik, një anëtarë nga pesë;
- 28.08.2025: Komisioni Juridik, tre anëtarë nga pesë; Komisioni Ekonomisë, tre anëtarë nga pesë;
- 17.09.2025: Komisioni Juridik, tre anëtarë nga pesë; Komisioni Arsimit, dy anëtarë nga pesë; Komisioni Ekonomisë, tre anëtarë nga pesë;
- 30.09.2025: Komisioni Ekonomisë, pesë anëtarë;
- 21.11.2025: Komisioni Ekonomisë, tre anëtarë nga pesë;

Në total janë miratuar 52 vendime prej të cilave 11 vendime të konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, janë shqyrtuar 41 akte individual,

Gjithashtu, kemi miratuar planin e punës të shoqëruar me planin e konsultimeve dhe buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin me qëllim përmbushjen e të gjithë aktivitetit të parashikuar.

Këshilli i bashkisë Mallakastër ka transmetuar live mbledhjet e këshillit bashkiak, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të jap mendime dhe sygjerime për çështje të ndryshme.

Në vitin 2025 u realizua Raporti Vjetor i Punës së Këshillit Bashkiak Mallakastër pr vitin 2024.

Shpenzimi i buxhetit të këshillit:

- Buxheti për dëgjesat publike;
- Buxheti për aktivitete;
- Buxheti për botimin e boletinit me aktivitetet vjetore të këshillit;
- Buxheti për realizimin e një vizite studimore me pjesëmarrje të Këshillit bashkiak dhe përfaqësues të bashkisë, në një Këshill/bashki homologe brenda vendit, i cili u realizua në Korçë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e marrdhënieve për bashkëpunime në të ardhmen;
- Në total nga buxheti i këshilli është shpenzuar 60%.

3. Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit:

Në kuadër të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës dhe vendimmarrës, Këshilli Bashkiak, gjatë shqyrtimit të të gjitha projektvendimeve të paraqitura nga organi ekzekutiv, ka zhvilluar diskutime të detajuara, duke adresuar sqarime dhe pyetje të ezazuara ndaj administratës përkatëse. Këto sqarime kanë pasur për qëllim garantimin e transparencës, ligjshmërisë dhe efektivitetit në procesin e vendimmarrjes, si dhe sigurimin e një informacioni të plotë dhe të argumentuar përpara miratimit të çdo projektvendimi.

Në funksion të forcimit të rolit monitorues, Këshilli Bashkiak duhet të kërkojë nga administrata paraqitjen e raporteve periodike sqaruese, me frekuencë tremujore, mbi ecurinë, nivelin e zbatimit

dhe problematikat e hasura në ekzekutimin e vendimeve të miratuara. Këto raporte duhet të përmbajnë të dhëna konkrete mbi progresin, masat e ndërmarra, afatet e realizimit, si dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të zbatimit.

Referuar vitit 2025, rezulton se të gjitha vendimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak janë ekzekutuar në përputhje me përcaktimet përkatëse, me përjashtim të atyre vendimeve që lidhen me projekte financimi afatgjata. Këto të fundit, për shkak të natyrës së tyre dhe angazhimeve buxhetore shumëvjeçare, kërkojnë një shtrirje kohore trevjeçare për realizimin e plotë, sipas planifikimit financiar dhe fazave të parashikuara të zbatimit.

SEKRETAR KËSHILLI

ZINAIDA AHMETAJ

